# Komuna e Gjakoves

## Pasqyrat Financiare

## për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2008

### (me raportin e auditorit te pavarur bashkangjitur)

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telefax +381 38 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

# Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Kuvendin Komunal
Komuna e Gjakovës, Kosovë

Prishtinë, 5 shkurt 2010

Ne u angazhuam të auditojmë pasqyrat financiare bashkëlidhur të Komunës së Gjakovës ("Komuna"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008, një krahasim të buxhetit me shumat aktuale, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese. Pasqyrat financiare të Komunës më datë dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2007 u audituan nga një auditues tjetër, raporti i të cilit daton 26 dhjetor 2008, dhe shprehte një refuzim për të dhënë opinion si pasojë e mungesës së informacionit financiar të plotë në pasqyrat financiare dhe pajtueshmërise rregullatore të tyre, mungesës së saktësisë dhe plotësisë së të hyrave, mungesës së saktësisë së regjistrimeve të aktiveve fikse, mungesës së procedurave të përshtatshme dhe të besueshme të kontrollit mbi prokurimin e lëndëve të zjarrit për Departmentin e Edukimit, menaxhimin e kontratave të furnizimit, detyrimet jo të plota dhe pagesat e furnitorëve si dhe pa-pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

*Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/13 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore.* Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

*Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Për shkak të çështjes së trajtuar në paragrafin 1 të Bazës për Refuzim për të Dhënë Opinion, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencë auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të bazuar një opinion auditimi

*Baza për Refuzim për të Dhënë Opinion*

1 Komuna duhet të mbajë lista të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në kontabilitet dhe në sistemet operacionale në lidhje me pagesat nga palët e treta, si dhe në mungesë të kontrolleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim ne gjendje të kryenim teste auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për verifikimin e plotësisë së pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008.

2 Komuna nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare të përgatitura më datë dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 disa shënime të kërkuara nga SNKSP *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 2008 /13 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore.* Në veçanti, sa më poshtë mungonin ose nuk ishin shpalosur në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare:

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch is a branch of KPMG Albania Sh.p.k., a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ('KPMG International'), a Swiss entity.

Registered with the Kosovo Business Registration Agency with Business no. 70291840

KPMG

- Shpjegimet e diferencave materiale midis buxheteve per te cilat Komuna është publikisht përgjegjëse dhe shumave aktuale të paguara nuk janë paraqitur.
- Neni 13 *Obligimet raportuese sipas LMFPP* nuk është plotësuar.

Si pasojë, ne nuk ishim në gjendje të siguroheshim në mënyrë të arsyeshme mbi plotësinë dhe përputhshmërinë rregullatore të informacionit financiar të paraqitur nga Komuna më datë dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008.

3 Komuna nuk ka shpalosur ndonjë shumë për pronat, objektet dhe pajisjet në shënimin 27 të pasqyrave financiare. Për më tepër, ka disa mungesa dhe pasiguri që ndikojnë raportimin financiar të Komunës për pronat, objektet dhe pajisjet si më poshtë:

- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.
- Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshire këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve dhe mungesave të tjera të shpjeguara më sipër, ne nuk mundëm të përcaktojmë çfare rregullimesh mund të ishin të nevojshme për informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës.

4 Komuna nuk ka bërë asnjë rregullim në pasqyrat e saj financiare për informacionin krahasues të viteve të mbyllura më 31 dhjetor 2007 dhe 31 dhjetor 2006. Në veçanti, sa më poshtë mungonin ose nuk ishin shpalosur në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare:

- Informacioni krahasues për vitet 2007 dhe 2006 në Nenin 10 *Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme* nuk barazon me Shënimin 9.
- Informacioni krahasues mbi grantet dhe të hyrat e mbartura prej viteve të shkuara për vitet 2007 dhe 2006 në Nenin 11 *Raporti i Ekzekutimit te Buxhetit* nuk është i saktë dhe i plotë.

Meqenëse pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2007 morën një refuzim për të dhënë opinion, treguesit krahasues të përshkruar më sipër mund të jenë me anomali materiale.

*Refuzim për të Dhënë Opinion*

Për shkak të rëndësisë së çështjes së trajtuar në paragrafin 1 të Bazës për Refuzim për të Dhënë Opinion ne nuk shprehim ndonjë opinion mbi këto pasqyra financiare.

KPMG

Rishikimi i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

*Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare.* Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

*Konkluzion për Përputhshmërinë*

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

*Çështje të tjera*

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

1 Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Komuna nuk ka implementuar një program të integruar kompjuterik kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacion të plotë, të saktë, dhe në kohë për qëllime raportimi.

2 Megjithese Kryetari i Komunës ka nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ishte në gjendje të përgatiste një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.

3 Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, dhe nuk mban lista apo llogari të vecanta për të gjithë debitorët e saj për detyrime të lidhura me taksa të ndryshme. Vetëm arkëtimet në para të gatshme nga të hyrat regjistrohen. Megjithëse llogaritë e arkëtueshme nuk kërkohen të shpalosen në pasqyrat financiare, mungesa e saktësisë dhe plotësisë së tyre do të ndikojë në të hyrat që Komuna mund të fitojë dhe në aftesinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.

4 Komuna nuk ka mbajtur lista të pagesave nga palët e treta. Evidencat e disponueshme dhe kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për tu siguruar se pagesat nga palë të treta prezantohen dhe menaxhohen në përputhje me legjislacionin përkatës dhe përdoren për qëllimin e synuar nga legjislacioni, ishin të limituara.

5 Ne identifikuam një numër mospërputhjesh me Ligjin Nr. 2003/17 'Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë' (ndryshuar). Këto mospërputhje lidheshin me procedura të kërkuara të cilat nuk ishin kryer dhe dokumentuar nga Komuna.

6 Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundur që pagesa të parasë së gatshme të kërkohen në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka kryer ndonjë proces formal që mund të sigurojë infomacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provigjoneve dhe detyrimeve kontigjente.

KPMG Albania Sh.p.k. Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. – Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

*Shënim*

1 Sqarime të mëtejshme për rekomandimet dhe përgjigjet e manaxhmentit për keto sugjerime janë përfshirë në Shtesën 1 të këtij raporti.

2 Një sqarim për format e ndryshme të modifikimeve të një opinioni auditimi është përfshirë në Shtesën 2 të këtij raporti.

# Shtesa 1

# 1 Te përgjithshme

## 1.1 Auditimi për vitin 2008

KPMG Albania Sh.p.k. – Dega Kosove ("KPMG") është emëruar për te ushtruar auditimin e pasqyrave financiare te Komunës së Gjakovës ("Komuna") të përgatitura në bazat e parasë së gatshme në pajtim me SNKSP *Raportimi Financiar në para të gatshme,* për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2008.

Këshilla jonë në këtë dokument kufizohet në konkluzionet e specifikuara në vazhdim dhe është bazuar në plotësinë dhe saktësinë e fakteve të paraqitura më poshtë, supozimeve dhe prezantimeve. Nëse ndonjë prej fakteve, supozimeve apo prezantimeve të përmendura nuk është tërësisht i plotë ose i saktë, atëherë është e domosdoshme që ne të informohemi menjëherë, duke qënë se pasaktësia dhe mungesa e plotësisë mund të kenë një efekt material në konkluzionet tona. Për dhënien e këshillës sonë, ne mbështetemi në dispozitat relevante të legjislacionit aktual në Kosovë, rregullave dhe interpretimeve juridike dhe administrative të saj. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve, në mënyrë retroaktive dhe/ose prospektive dhe ndryshime të tilla mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e konkluzioneve tona. Ne nuk do të përditësojmë këshillat tona për ndryshimet ose modifikimet e mëvonshme të legjislacionit dhe rregulloreve, ose të interpretimeve juridike apo administrative të tyre.

## 1.2 Pasojat

Raporti ynë është planifikuar të përfshijë rekomandime të dobishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave të kontabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe kontabilitetit të Komunës si dhe në shmangien e dobësive që mund të çojnë në humbje materiale ose në gabime. Ky raport është i hartuar vetëm për informim dhe përdorim nga ana e menaxhmentit të Komunës, Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Ministrisë së Ekonomise dhe Financave, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Asamblesë, dhe nuk duhet të përdoret nga asnjë palë tjetër që nuk është e specifikuar. Është detyrimi juaj të ndërmerrni veprimet e nevojshme për korrigjimin e dobësive dhe nëqoftë se ju dështoni në të, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për humbjet apo gabimet që mund të ndodhin si rezultat.

## 1.3 Përjashtimi i pasojave

Siç kemi rënë dakord, ju gjithashtu keni pranuar që për arsye të rëndësisë në punën tonë të informacionit dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Komuna, drejtuesit e saj, punonjësit apo agjentët ju, përveç rasteve të neglizhencës, keqbesimit ose pakujdesive të paramenduara, nuk do të na quani përgjegjës ose fajtorë për ndonjë humbje ose të tjera pasoja në qoftë se informacioni i rëndësishëm për punën tonë na është mbajtur apo fshehur me qëllim, ose na është paraqitur në mënyrë mashtruese.

## 1.4 Struktura e këtij raporti

Çdo kategori e vëzhgimeve është e përshkruar në një faqe të veçantë. Për çdo vëzhgim struktura është: *vëzhgimi dhe statusi aktual nese eshte e aplikueshme, rreziku, rekomandimi dhe përgjigja e menaxhmentit.*

# 2 Çështjet e ngritura gjatë vitit aktual

## 2.1 Përgatitja e Pasqyrave Financiare

### 2.1.1 Vëzhgimi

Informacion parësor ne te cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është Free Balance. Edhe pse Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në Access, Komuna nuk ka një sistem të brendshëm kontabël që të përdoret për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet ne pasqyrat financiare.

Megjithëse Kryetari i Komunës ka nënshkruar Deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhën angleze dhe serbe përpara fillimit te auditimit. Gjatë periudhës së auditimit ne shpenzuam kohe dhe burime të konsiderueshme në asistimin e Komunës për të përmirësuar prezantimin e pasqyrave financiare në gjuhën angleze. Për më tej, Komuna nuk ishte në gjendje të dorëzonte një variant final të pasqyrave financiare në serbisht deri në fund të auditimit tonë.

Për më tepër, informacioni ne vijim qe kërkohet te shpaloset ne pasqyrat financiare nuk është i regjistruar ne Free Balance dhe nuk është pjese e një software te integruar te kontabilitetit

- Pagesat nga palët e treta
- Patundshmëritë, prona dhe pajisjet,
- Faturat e papaguara (detyrimet)

Edhe pse Komuna mund te jete e përfshirë ne ceshtje te vogla gjyqësore dhe është e mundur qe te ketë dalje te parase te gatshme ne te ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedure formale qe do te siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe te besueshëm për te regjistruar provizionet për detyrimet kontingjente.

Si pasojë e dobësive të përmendura më sipër permenden shpalosje jo te plota ose të pasakata në pasqyrat financiare.

- Shënimi 13. *Te hyrat vetanake* nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit administrativ Nr 2008/13. Komuna nuk i ka kategorizuar të hyrat vetanake sipas atyre të përcaktuara me udhëzim, por ka përdorur kategoritë e saj të brendshme për të shpalosur këtë informacion.
- Shpjegimet e diferencave materiale ndërmjet buxhetit për të cilin komuna eshte publikisht pergjegjese dhe shumave aktuale nuk janë shpalosur.
- Seksioni 13, *Raporti i obligimeve te departamenteve sipas LMFPP* nuk është plotësuar.
- Seksioni 16 Shënimi 27. *Pasuritë Jo-financiare* nuk është i plotë dhe i saktë.
- Mund te ketë pagesa te konsiderueshme nga palët e treta, për shembull raste kur një pale tjetër si një ministri apo donator i huaj blejnë/kontribuojnë një pasuri për përdorim nga Komuna, dhe kjo për shkak se nuk është e regjistruar ne Free Balance nuk është e prezantuar ne pasqyrat financiare.
- Informacioni krahasues për vitet 2007 dhe 2006 në seksionin 10 *Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme* nuk përputhet me shënimin 9. Edhe informacioni krahasues per grantet dhe te hyrat vetanake të mbartura nga vitet e kaluara në Seksionin 11 *Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit* nuk është i plotë dhe i saktë.

KPMG

### 2.1.2 Rreziku

Mangësitë në kontrollet e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe gabime për sa vijon:

- Plotësia dhe saktësia e informacionit financiar;
- Integritet te te dhënave;
- Ruajtja e pasurive, dhe
- Mungesa e regjistrimit te pagesave nga pale te treta mund te rezultoje ne pasuri/sherbime te perdorura pa qera nga pale te tjera, te ndryshme nga Komuna.

### 2.1.3 Rekomandim

Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për tu siguruar se informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.

### 2.1.4 Përgjigja e Menaxhmentit

Të hyrat vetanake janë regjistruar dhe mbahen në bazë të udhëzimeve administrative dhe tabelave nga Ministria e Ekonomise dhe Financave ('MEF').

Raportet e obligimeve te departamenteve sipas LMFPP janë paraqitur te tabela e borxheve sipas kërkesës se MEF-it.

Pagesat nga palët e treta si per shembull Ministritë, nuk janë paraqitur sepse Ministritë nuk japin informata për investime ne Komunë.

Informacioni krahasues ne tabelën 10 dhe 11 është i plotë dhe i saktë sipas regjistrave të Komunës dhe Free Balance.

## 2.2 Menaxhimi i pronës, objekteve dhe pajisjeve

### 2.2.1 Vëzhgimi

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve ne posedim të saj. Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të patundshmërive, përfshire këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë për keto pasuri, dhe informacion për statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Kadastar ose në Gjykatë.

Komuna ka krijuar një komitet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive. Ky komitet nuk përbëhet nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat në listë nuk janë mbështetur me një raport vlerësimi. Regjistrimi i pasurive të Komunës është ende në proces.

Ne nuk na është ofruar ndonjë evidencë për inventarin fizik me 31 Dhjetor 2008 dhe si pasojë verifikimi i regjistrave kontabël me numërimin fizik të pasurisë ishte i pamundur.

Për shkak te natyrës se te dhënave te tilla, Komuna nuk ishte ne gjendje të:

- shpalosë informacionin e kërkuar për patundshmëritë, pronat dhe pajisjet ne pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2008 dhe me 31 Dhjetor 2007; dhe
- të na sigurojë rakordimin e informacionit te regjistruar ne kontabilitet me tabelat e vleresimit ose me ndonjë analize tjetër, para aprovimit te pasqyrave financiare.

### 2.2.2 Rreziku

Mungesa e një regjistri gjithpërfshires te pronës, objekteve dhe pajisjeve dobëson kontrollet e brendshme mbi këto te fundit dhe mund të çojë deri në keqpërdorim të pasurive dhe ne mos identifikimin e këtyre keqpërdorimeve ne kohen e duhur. Për me tepër, menaxhmenti mund te humbase kohe dhe përpjekje për te identifikuar detajet dhe vlerën e mbartur te aseteve gjate proceseve vendim-marrëse.

Komuna mund te mos jete ne gjendje të kontrollojë shfrytëzimin momental te pasurisë se saj nga palët e treta dhe si pasoje mund te mos i mbledh te hyrat nga qiraja nga këto patundshmëri.

Si pasoje e natyrës se regjistrimeve te saj dhe mungesës se vleresimit te duhur te pasurive, Komuna mund te mos jetë ne gjendje te pajtohet me kërkesat e raportimit.

### 2.2.3 Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do te konsideroje si me poshte:

- Të mbaje një regjistër gjithëpërfshirës te pronës, objekteve dhe pajisjeve.
- Te përfshije burime shtese ne regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive te Komunës. Përfshirja e vlerësuesve te pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme dhe praktika me e mire ne raste te tilla.
- Te beje numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve te tyre dhe te barazojë rezultatet e numërimit me te dhënat ne kontabilitet dhe regjistër.

- Te beje përpjekje shtese ne lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive.

### 2.2.4 Përgjigja e Menaxhmentit

Patundshmëritë e Komunës janë te regjistruara ne kadastër ne emër te Komunës dhe ekziston regjistri i pronës, objekteve dhe pajisjeve (Gani, ne regjistra nuk jane objektet e reja dhe rruget qe jane prone e komunese per ekte ne kemi dhene se nuk jane listat e plota)

Komision profesional i vlerësimit është kompetencë e MEF-it

Evidentimi i inventarit te komunës është i ber ne fund te vitit ekzistojnë raportet e regjistrimit për tërë inventarin e komunës.

## 2.3 Te hyrat

### 2.3.1 Vëzhgimi

- *Sistemi i faturimit.* Ekziston vetëm një sistem automatik i faturimit për tatimin në pronë. Pjesa tjetër e faturimit të Komunës nuk është e regjistruar. Per keto te hyra regjistrohen vetem arketimet e parave.
- *Mbledhja e të hyrave.* Përveç tatimit mbi pronën, qirasë dhe hyrave nga licencat për biznese, menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra ose lista për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksa të ndryshme. Pa të dhëna të detajuara, të mjaftueshme dhe të sakta për debitorët, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë për koeficientët e mbledhshmërise së të hyrave, apo të përcjellë mbledhjen e të hyrave vetanake në kohën e duhur.
- *Të hyrat nga licencat e biznesit.* Komuna nuk merr përditësimet për numrin e bizneseve aktive nga Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Si pasojë, bizneset joaktive ose të mbyllura mund të faturohen, ndërsa bizneset aktive mund të mos faturohen.
- *Barazimi i të hyrave.* Nuk është bërë ndonjë barazim ndërmjet regjistrimeve të bëra nga kontabiliteti, Zyrtari që merret me të hyrat vetanake dhe departamenti i operacioneve ne 2008, për të ardhurat e gjeneruara nga kampuset e studentëve, libraritë dhe qendra e kulturës. Dallimet që janë identifikuar gjatë rakordimit nuk janë korrigjuar në fund të vitit për diferencat ne tatimin ne pronë prej 865 Euro.
- *Te hyrat nga qiraja.* Komuna ka nënshkuar një kontratë qiraje në vitin 2003, e cila nuk është rinovuar. Po ashtu disa nga kontratat që ne kemi kontrolluar kanë çmim më të ulët se çmimi sipas rregullores komunale. Nga testet e bera për te hyrat ne qira ne kemi identifikuar nje diference prej 420 Euro me pak ne FS se qiraja sipas listës se kontratave. Vetëm 21% e totalit të qirasë së arkëtueshme duke përfshirë edhe të arkëtushmet e viteve të kaluara është mbledhur në 2008. Ndërkohë mbledhja e të hyrave të qirasë në 2008 duke përfshirë edhe vitet e kaluara është 67% e totalit të qirasë për 2008.
- *Te hyrat nga njësit komunale.* Te hyrat nga njësitë e tjera komunale si shkolla, qendra kulture dhe spitale per pjesmarrja te nxënësve, donacione ne para të gatshme ose ne forma apo të ardhura të tjera nuk ishin rakorduar apo raportuar në detaje depatamentit të financës.

### 2.3.2 Rreziku

Meqenëse për të arkëtueshmet nuk kërkohet shpalosja ne pasqyrat financiare, mungesa e saktësisë dhe plotesise do te ndikoje te hyrat qe Komuna mund te fitojë.

Kontrolle jo te duhura dhe te pamjaftueshme ne lidhje me te hyrat dhe software-in dhe sistemin e faturimit, rrisin rrezikun e manipulimit te te dhënave dhe keqpërdorimit te informacionit. Një sistem i tille mund të çojë në faturim dhe të hyra jo të plota.

Regjistrimi manual dhe mungesa e lidhjes se sistemit te faturimit dhe sistemit te kontabilitetit ne mënyre automatike, e ekspozon Komunën ndaj rrezikut shtese te gabimit. Për me tepër, kjo shkakton kosto shtese për mbajtjen e te dhënave, rishikimin dhe barazimin e informacionit.

Një liste e detajuar dhe e përditësuar e tatim paguesve, bizneseve aktive dhe debitorëve te gjeneruar nga sistemi është me rëndësi te veçante ne situatën e tanishme ku komunat nuk e regjistrojnë secilin transaksion individual ne Free Balance. Si pasoje, përveç tatimit mbi pronen,

Thesari dhe Komuna, nuk kanë një liste te detajuar te gjeneruar nga sistemi i kontabilitetit ose sistemi i faturimit. Si rezultat i kësaj, nuk është e mundur te bëhen barazimet e nevojshme ose analiza sipas debitoreve.

### 2.3.3 Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për te përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe te faturimit ne mënyre qe te siguroj kontrolle te sigurta, eficiente dhe efektive ne faturim dhe te hyra. Përmirësimi i procedurave te lidhura me keto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit te monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe te sigurojë qe vendimet ne lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e te hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës te konsideroj pikat si ne vijim:

- Implementimin e një sistemi te faturimit qe përfshin detaje te përditësuara për paguesit, adresën e tyre te tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes se te hyrave nga këta pagues. Qasje ne informacion te tille duhet te kenë vetëm një numër te limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.
- Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave ne sistem ne mënyre qe të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet te autorizohet dhe te rishikohet.
- Të ekzistojë një lidhje automatike ne mes te sistemit te faturimit dhe sistemit te kontabilitetit ne mënyre qe informacioni te procesohet automatikisht ne librin kryesor te kontabilitetit.
- Të ushtrojë barazime te rregullta midis dy sistemeve ne periudha te rregullta për te gjitha tipet e te hyrave. Ne rastet kur ka diferenca, ato duhet te hulumtohen dhe te zgjidhen brenda afatit te caktuar.
- Te lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe te bëhen barazime te rregullta ne mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me sherbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme ne rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.

### 2.3.4 Përgjigja e menaxhmentit

Sistemi i faturimi është rregulluar ne nivel qendror , te gjitha organizatat buxhetore lëshojnë uniref-at për te gjitha te hyrat Komunale ne vende te faturave.

Pagesat 10 € e me pake komuna nuk mban evidencë kontabël por mban evidencë ne total psh. Certifikatat e lindje,vdekjes. taksa për automjete,sekuestrimet e automjeteve etj.

Ministria nuk i përcjell te dhënat e rregullta Komunave por me decentralizim do te barten ne vitin 2010.

Sipas shënimeve tona zyrtare dhe dokumenteve te Fribalancit te datës 27/1/2009 te hyrat ne tatim ne pronë barazohen ne vlerën – 859.575,85 €

Mos evidentimi i te hyrave nga shkollat ka qen si pasoj e mos raportimit te drejtorëve te shkollave për te hyrat e grumbulluara nga participimet e ndryshme: certifikatat e nxënësve,sallat e sportit,ekskursionet,veshmbathjet etj.

## 2.4 Shpenzimet

### 2.4.1 Vëzhgimi

*Pagat dhe mëditjet*

- Komuna nuk ka një sistem të listës së pagave, ku mund te përdoret si burim i besueshëm i informacionit për të mbështetur shifrat në pasqyrat financiare. Në vend të kësaj komuna ka përdorur listat e pagave të të dhënave nga Ministria e Shërbimeve Publike.
- Nga zgjedhja jone, ne katër raste mungonin format e vlerësimit. Ne nuk gjetëm pershkrimin e punës dhe kodin e etikës për të gjithë rastet e zgjedhjes sonë dhe gjithashtu vendimet për rekrutimin e stafit dhe formen e deklarimit te stafit që i dërgohet Ministrisë së Shërbimeve Publike për vendet e reja të lira.

*Procedurat e prokurimit*

- Komuna nuk ka përgatitur një plan për procedurat e detajuara të prokurimit të bazuar në buxhetin e aprovuar. Ne identifikuan 10 raste (Nr 08 028 511; 632 08 032 521; 632 08 032 521; 632 08 027 521; 063 08 094 521; 063 08 024 521; 063 08 068 511; 632 08 057 521; 632 06 06/10/06 511) ku puna ka filluar para se fondet të ishin siguruar.
- Tenderi me numër 063 08 094 521 për 237,637 EUR nuk ka kaluar neper procedurat formale te vlerësimit. Formularët e vlerësimit te ofertave nuk janë te plotësuar dhe nuk dihet se si është bërë përzgjedhja e ofertës me te mire.
- Për projektet me numër 063 08 068 511 dhe 632 06 06/10/06 511 nuk janë caktuar menaxherë projekti të cilët janë përgjegjës për cilësinë e punës dhe konfirmimin qe punët janë kryer ne afatin e duhur.
- Projektet me numër 063 08 094 521 & 632 06 06/10/06 511 janë paguar edhe pse nuk ka pranim final te punëve te kryera. Ne veçanti, për tenderin me numër 632 06 06/10/06 511 me vlere totale prej EUR 601,534.88 nuk ka asnjë evidence qe komuna ka paguar shumën prej EUR 300,001.18 qe ka pasure obligim sipas kontrate. Sipas shpjegimeve të marra nga oficeri i prokurimeve, Ministri i Kulturës e ka bërë këtë pagesë. Sidoqoftë, ne nuk kemi marrë ndonjë dokument që mbështet pagesën apo detyrimin e Ministrisë për të paguar.
- Nga rastet e testuara kemi gjetur dy fatura 57/1 dhe 57.2/1 qe kane te bëjnë me tenderat me Nr 632 08 057 521 qe janë paguar pa marre paraprakisht nga te kontraktuarit garancine e ekzekutimit te punëve.
- Ne vumë re që ishin bërë disa ndryshime për projektin me numër 632 08 040 521 që është një projekt i financuar nga Komuna për ndërtimin e tri zyrave lokale ne tre fshatra te ndryshme. Megjithëse ishte bërë ndryshimi i destinacionit të një zyre ne nuk morëm asnjë dokument që të provonte këtë ndryshim.
- Për te gjitha shpenzimet qe janë bere për ditën e pavarësisë si blerja e flamujve per 5,455 Euro, vendosja e bilbordave dhe flamujve ne vlere 3,582 Euro, rregullimi i ambienteve ne vlere 4,935 Euro, organizimi i koncerteve ne vlere 4,585 Euro dhe darka e shtruar me vlere 4,658 Euro, nuk ka evidencë qe dëshmon aplikimin e procedurave të tenderimit.
- Me date 10 Prill 2008 Komuna ka vendosur që të financojë një organizate lokale pa zbatuar procedurat e ligjit te prokurimit, për shumën 32 mije euro.

*Faturat e papaguara (detyrimet)*

Faturat e papaguara të detajuara në Shënimin 25 për shumën 1,436 mijë Euro, së bashku me pagesat e 2008 prej 10,612 mijë Euro përbejnë në total 12,048 mijë Euro. Kjo shumë kalon

buxhetin final të aprovuar prej 11,543 euro. Megjithese pjesa më e madhe e faturave të papaguara lidhet me faturat e dhjetorit, ne theksojmë se disa detyrime përbëjnë fatura të vjetra.

### 2.4.2 Rreziku

Megjithese gjetjet e lartpërmendura nuk kanë efekt material ne pasqyrat financiare, mungesa e komunikimit ne kohe dhe aprovimet nga autoritetet përkatëse ose mungesa e dokumentacionit ne dosjet e prokurimit mund te coje deri ne mos përputhje me Ligjet dhe kërkesat e Rregulloreve.

Komuna do të jetë në gjendje të marrë më shumë shërbime në një vit se niveli i aprovuar nga buxheti, nëse ajo shtyn pagesën e faturave deri në vitin pasardhës.

### 2.4.3 Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do te ndërmarre hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe te jetë ne pajtueshmëri te plote me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

### 2.4.4 Përgjigja e menaxhmentit

MEF-i ka nxjerr udhëzimin administrativ 2008/1 neni 5 pika 1,5.2 dhe 5.3 qe do te thotë se Organizatat Buxhetore mund te fillojnë procedurën e prokurimit duke qen te sigurt se fondet për projekte përkatëse janë te siguruara ndërsa kontratën e nënshkruan pasi te keni zotue fondet përkatëse.

Pikës dy: vendimi për menaxher te projektit ekziston

Pagesa e Komunës ekziston: pagesa e par me date 19/12/06 CPO 619 vlere 194769.93 €
20/5/08 CPO 1035 vlere 62.000,00 €,21/7/08 CPO nr 1437 38.000,00€ dhe pagesa e fundit me date 6/11/08 CPO nr 2090 ne vlerë 6.763,78 € pagesa te kryera nga Komuna.

Garancion i sigurisë për pagës i fat. 57/1, 57.2/1 dhe fat. 57 janë te paguara garancioni i sigurisë i përbashkët ne vlerë 1.977,00 € për tri shumat (6.315,00€ , 4.300,00€, dhe 9.159.97€)

Për shkak te shpejtësisë se ngjarjes me rastin e pavarësisë ka pasur procedura urgjente.

Pagesa e subvencionit prej 32.000,00 € është ber sipas”Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit – 02 31 Mars 2009 mbi shpenzimet e parave publike neni 43. dhe udhëzimi administrativ 2005/08”

## 2.5 Auditi i brendshem

### 2.5.1 Vëzhgimi

Komuna nuk ka krijuar Këshill të auditimit. dhe nuk ka kryer një përcjellje të rekomandimeve të bëra nga auditorët e brendshëm.

### 2.5.2 Rreziku

Mungesa e një Komiteti Auditimi dhe e një ndjekje të rekomandimeve të bëra nga auditorët e brendshëm, rrit rrezikun e dështimit të kontrolleve të brendshme. Për më tej, nuk lejon që funksionet të cilat mbulohen zakonisht nga një Komitet Auditimi të kryhen me pavarësinë e duhur nga Komuna.

### 2.5.3 Rekomandim

Kryetari i Komunes duhet të konsiderojë krijimin e një funksioni te Auditimit te brendshëm dhe një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë të lidhur me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standart të lartë 'udhëheqje të korporatës'. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në sa më poshtë:

- Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore;
- Plani i auditit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditit të brendshëm.

### 2.5.4 Përgjigja e menaxhmentit

Ketë vit është paraparë qe te zgjidhet komiteti për auditim

# 3 Çështjet e ngritura vitin e kaluar

## 3.1 Vëzhgimet e vitit të kaluar

**1. Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar**

a) Pasqyrat financiare të komunës që janë paraqitur në shtojcën e këtij raporti janë të mangëta në terme të formës dhe përmbajtjes së tyre siç është përshkruar nga dispozitat relevante të vendosura nga autoritetet dhe si të tilla ato nuk janë në pajtueshmëri me kërkesat e Nenit 41: Raportimi final mbi buxhetin nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 2003/2, ku përshkruhet saktësisht formati dhe përmbajtja e pasqyrave financiare të komunave.

b) Komuna ka raportuar në pasqyrat financiare vjetore të hyrat e tatimit në pronë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007 në vlerë 451,670 Euro, përderisa sipas të dhënave nga departamenti i tatimit në pronë, të hyrat nga tatimi në pronë janë 456,548 Euro.

c) Duke u bazuar në procedurat e kryera të auditimit ne identifikuam se të dhënat e të hyrave siç janë shpalosur në pasqyrat financiare të komunës dhe atyre të marra nga departamenti i thesarit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nuk janë barazuar. Gjithsej ndryshimi prej 312,941 Euro përbëhet nga ndryshimet ndërmjet të dhënave të të hyrave të llogaritura në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe të raportuara për sa u përket gjobave të trafikut për 161,910 Euro, pastaj gjobave të gjykatës për 150,526 Euro dhe agjencisë pyjore për 505 Euro.

d) Komuna ka regjistër jo të plotë të aseteve fikse. Gjatë ekzaminimit tonë ne kemi identifikuar se komuna mban të dhëna vetëm për asetet e blera nga viti 2002. Veq kësaj llogaritja e zhvlerësimit mbi asetet fikse nuk është kryer. Për më tepër kemi gjetur se komuna kryen verifikim vjetor të ekzistencës fizike të aseteve më 31 Dhjetor por nuk është bërë barazimi I librave të komunës me rezultatet e numërimit fizik.

**2. Përcaktimi dhe efektiviteti operativ i kontrolleve të brendshme**

a) Nga inspektimi i dokumenteve burimore për prokurimin e drurit për djegie të bërë nga departamenti i arsimit për dy shkolla në shumën 1,020 Euro ne nuk gjetëm ndonjë dëshmi se personat përgjegjës kanë zbatuar procedurat e duhura të autorizimit që do të vërtetonin vlefshmërinë dhe plotësinë e prokurimit. Ne nuk arritëm të identifikonim personin që ka nënshkruar si pranues dhe fletë dërgesa nuk është vulosur nga institucioni pranues (shkolla).

b) Gjatë inspektimit tonë të dokumenteve burimore në departamentin e prokurimit ne gjetëm se nëpunësi i prokurimit nuk mund të na ofronte informata të sakta, të azhurnuara mbi detajet e kontraktorëve të prokurimit, pagesat që u janë bërë atyre si dhe detajet e detyrimeve të pashlyera nga furnitori.

**3. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret**

a) Duke u bazuar në ekzaminimin tonë mbi implementimin e disa afateve dhe kushteve kontraktuese të prokurimit, ne gjetëm dy raste siç janë treguar më poshtë, ku organet autorizuese te komunës kane dështuar në kërkimin dhe inkasimin e gjobave për shkak të vonesave te furnizuesve në shlyerjen e obligimeve të tyre, siç janë: Punët ndërtimore në shollën fillore “Selman Riza” dhe Ndërtimi i çatisë dhe sallës së madhe të kuvendit komunal.

